



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 288 Akti

Nr. 179 Vendimi

Tiranë, më 10.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 10.7.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Aleksandër Muskaj, ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë, për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës.
2. Procesi i rivlerësimit për z. Aleksandër Muskaj, ka filluar menjëherë me:
 - a. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;

- b. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c. Plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.
3. Subjekti i rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
 4. Trupi gjykues, i shortuar për shqyrtimin e çështjes, përbëhet nga:
 Etleda Çiftja
 Valbona Sanxhaktari
 Xhensila Pine
 Në mbledhjen e parë të trupit gjykues, ne 27.03.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes, komisionere Xhensila Pine. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.
 5. Z.Aleksandër Muskaj nga data 08.07.2008, është emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, detyrë që ai e ka ushtruar deri në dorëzimin e deklaratës së pasurisë “Vetting”. Në datën 31.07.2017 ai ka dorëzuar detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Në vijim të kësaj procedure është deklaruar mbarimi i mandatit të gjyqtarit në këtë gjykatë me vendimin nr. 2, datë 29.06.2017, të Gjykatës së Lartë.
 6. Subjekti i rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, në datën 16.11.2018, ka depozituar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë kërkesën për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Bazuar në nenin 139/pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe 61 pika 4 dhe 62 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që iu mbaron mandati gëzojnë të drejtën për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë në nivel Apeli. Nisur nga ky parashikim ligjor Këshilli i Lartë Gjyqësor i është drejtuar me shkrim subjektit të rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë për realizimin e të drejtës së caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli sipas parashikimeve ligjore.
 7. Në përgjigje të kësaj shkrese në datën 08.04.2019, subjekti i rivlerësimit z. Aleksandër Muskaj, ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, heqjen dorë nga statusi i magjistratit.
 8. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. 63, datë 24.4.2019, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Aleksandër Muskaj, ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

9. Me shkresën me nr. *** prot., datë 25.4.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar pranë Komisionit, vendimin nr. 63, datë 24.04.2019, “Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Aleksandër Muskaj, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli”.

ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Në pikën 5 të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të paragrafit 3, të nenit 139”.
11. Në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës parashikohet mundësia e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:
- “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet.*
- 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*
12. Në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur ai jep dorëheqjen.
13. Në nenin 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon:
- “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para këshillit përkatës.*
- 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja i jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur këshilli merr deklarin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”*
14. Në pikën 1, të nenit 161, për dispozitat kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet: “Gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet magjistrat sipas këtij ligji dhe sipas pikës 2: “anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm”.
15. Vendimi Nr. vendimi 5 datë 10.09.2018, i Kolegjit të Posacem të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, në pikën 21 ka interpretuar, ndër të tjera, si vijon:
- “[...] në përputhje me leximin në harmoni të dispozitave të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të pikave 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, të cilat së bashku përmbajnë racionin e procesit të rivlerësimit. Më konkretisht, gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që kërkojnë të qëndrojnë në detyrë duhet t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit ex officio, kurse subjektet të cilat do të japin dorëheqjen kanë si pasojë ligjore ndalimin e mundësisë së emërimit në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare.”*

16. Komisioni u njoh me kërkesat e subjektit të rivlerësimit: “për dorëheqjen nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli” dhe “për mosmbajtjen e statusit të magjistratit”, si dhe me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për mbarimin e statusit të magjistratit në datën 24.4.2019, për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, z. Aleksandër Muskaj.
17. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli dhe nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet: subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 10.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Kryesuese

Valbona Sanxhaktari
Anëtare

Xhensila Pine
Relatore

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj